



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI MBIKËQYRËS

VENDIM
Nr. 80, datë 16.12.2020

PËR

MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E NDËRHJRJES SË BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM TË KËMBIMEVE VALUTORE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 2, të nenit 43, shkronjat “a”, “b” dhe “c”, të nenit 60, pika 2 dhe të nenit 61, shkronja “a” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të vendimit të Këshillit Mbikëqyrës nr. 29, datë 2.3.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare”; me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë rregulloren “Për procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore”, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Komiteti i Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Kabineti i Guvernatorit në Bankën e Shqipërisë.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit me publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin në Buletinin Zyrtar.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në Fletore Zyrtare.

SEKRETARI

Elvis ÇIBUKU

KRYETARI

Gent SEJKO

KREU I

Të përgjithshme

Neni 1

Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore.

Neni 2

Baza juridike

Zbatimi i kësaj rregulloreje duhet të bëhet në përputhje me kërkesat e akteve të mëposhtme:

- a) ligjit “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- b) rregullores së Këshillit Mbikëqyrës “Mbi organizimin dhe funksionimin e Komitetit të Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare”;
- c) rregullores së Këshillit Mbikëqyrës “Për organizimin edhe funksionimin e Departamentit të Operacioneve Monetare”;
- d) rregullores së Këshillit Mbikëqyrës “Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë”;
- e) udhëzimit të Guvernatorit “Mbi procedurat e klasifikimit dhe administrimit të informacionit të klasifikuar “sekret bankar/profesional” në Bankën e Shqipërisë”.

Neni 3

Përkufizime

Në zbatim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) **“Qeveria”** – është Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë;
- b) **“Banka”** – është Banka e Shqipërisë;
- c) **“Bankat dhe degët e bankave të huaja”** – janë personat juridikë të licencuar nga Banka për ushtrimin e veprimtarisë bankare sipas ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- d) **“Ligji për Bankën e Shqipërisë”** – është Ligji nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- e) **“Spot”** – është marrëveshja e këmbimit valutor, sipas të cilës palët bien dakord për kursin e këmbimit dhe kalimin e fondeve në llogaritë e secilës prej tyre, deri në 2 ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes;
- f) **“Forward”** – është marrëveshja e këmbimit valutor, sipas të cilës palët bien dakord për kursin e këmbimit dhe për kalimin e fondeve në llogaritë e secilës prej tyre në një datë të caktuar, e cila është më tepër se 2 ditë pune pas datës së lidhjes së marrëveshjes;
- g) **“Swap”** – është blerja dhe shitja e njëkohshme, por me datë - valutë të ndryshme, e një monedhe kundrejt një tjetre;

- h) **“Datë-valutë”** – është data për të cilën dy kundërpalë bien dakord paraprakisht për kalimin e fondeve në llogarinë e njëri – tjetrit, në përmbushje të një veprimi financiar valutor;
- i) **“Kuotim”** – është shprehja e gatishmërisë së Bankës dhe/ose partnerit të tregtimit për të tregtuar një monedhë të huaj kundrejt Lekut për një shumë dhe çmim të caktuar;
- j) **“Sterilizim”** – është neutralizimi i efektit të ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor në gjendjen e likuiditetit. Sterilizimi mund të ndodhë nëpërmjet përdorimit të instrumenteve të menaxhimit të likuiditetit ose blerjes/shitjes me të drejta të plota të titujve të Qeverisë;
- k) **“Procedura e ndërhyrjes”** – është mënyra e propozimit, e marrjes së vendimit dhe e realizimit të ndërhyrjes në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore nga Banka;
- l) **“Ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor”** – është veprimi që ndërmer Banka me qëllim ndikimin e kërkesës dhe/ose ofertës për Lekë ndaj monedhave të huaja;
- m) **“Lloji i ndërhyrjes”** – është mënyra që përdor Banka për të ndërmarrë një ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor;
- n) **“Instrument i ndërhyrjes”** – është mjeti që përdor Banka për të realizuar ndërhyrjen në tregun e brendshëm valutor;
- o) **“Ndërhyrja me veprim”** – është ekzekutimi i një veprimi financiar për të blerë ose shitur një monedhë të huaj kundrejt Lekut nëpërmjet lidhjes së marrëveshjeve *spot*, *forward* ose *swap*, ose njoftimi i një ankandi të blerjes/shitjes së monedhës së huaj;
- p) **“Ndërhyrje e drejtpërdrejtë”** – është shfaqja e interesit ose marrëveshja dypalëshe ndërmjet Bankës dhe partnerit të tregtimit për shitjen ose blerjen e monedhës së huaj kundrejt Lekut nëpërmjet veprimeve financiare *spot*, *forward* ose *swap*;
- q) **“Instrument i ndërhyrjes së drejtpërdrejtë”** – është veprimi financiar *spot*, *forward* ose *swap* në monedhë të huaj kundrejt Lekut;
- r) **“Ndërhyrje me ankand”** – është lajmërimi nga Banka për ankand për shitjen ose blerjen e valutës kundrejt monedhës vendase nga bankat dhe degët e bankave të huaja, të cilat mund të kuotojnë për të blerë ose shitur monedhë të huaj në përputhje me procedura dhe rregulla të parapërcaktuara, dhe Banka përmbush kuotimet progresivisht duke filluar nga kuotimet më të favorshme financiarisht;
- s) **“Mënyra e realizimit të ndërhyrjes me veprim”** – janë rregullat e caktuara për përzgjedhjen e partnerëve në tregtim, për përcaktimin e shumës së tregtuar dhe të çmimit të tregtimit;
- t) **“Ndërhyrje me deklaratë”** – është çdo deklaratë verbale apo e shkruar e Bankës, në lidhje me nivelin e kursit të këmbimit të Lekut kundrejt monedhave të huaja, me objektiv të qartë influencimin e nivelit apo luhatshmërisë aktuale dhe/ose të ardhshme të kursit të këmbimit;
- u) **“Institucione financiare ndërkombëtare”** – janë institucione të cilat japin mbështetje financiare dhe konsulencë profesionale në lidhje me veprimtaritë e zhvillimit ekonomik dhe social në vendet në zhvillim dhe promovojnë bashkëpunimin dhe stabilitetin ekonomik ndërkombëtar;
- v) **“Çrregullim i tregut të brendshëm valutor”** – është:
 - i. mungesa e likuiditetit, si rezultat i të cilës partnerët e tregtimit kanë vështirësi në këmbimin e Lekut kundrejt monedhave të huaja dhe nuk janë në gjendje të mbajnë pozicione të hapura, e rrezikojnë tërheqjen e tyre nga tregu;

- ii. rritja e pajustificuar e ritmit të ndryshimit në një kah e kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja ose rritja e luhatshmërisë së kursit të këmbimit të monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja;
 - iii. zgjerimi i diferencës midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes së monedhës vendase kundrejt monedhave të huaja, të cilat kuotohen në tregun valutor;
 - iv. përqendrimi i ofertës ose kërkesës në një ose shumë pak pjesëmarrës të tregut, shoqëruar me rënien e vëllimit të veprimeve që kryhen në tregun valutor;
 - v. mosfunksionimi i qarkullimit të valutës nga ofruesit deri te kërkuesit e saj.
- w) **“Tregu i brendshëm valutor”** – është tregu në Republikën e Shqipërisë ku kryhet aktiviteti i këmbimit valutor të monedhave të huaja kundrejt Lekut nga partnerët e tregtimit;
- x) **“Kursi i këmbimit”** – është çmimi i monedhës vendase kundrejt një njësie të monedhës së huaj;
- y) **“Kursi i tregut”** – është kursi i llogaritur në mënyrë të njëjtë me kursin zyrtar të këmbimit, në momentin e kryerjes së veprimeve të tjera financiare;
- z) **“Limit”** – është shuma maksimale që bankat dhe degët e bankave të huaja janë të gatshme të tregtojnë me Bankën, në një veprim financiar të vetëm, e aplikueshme për veprimet në ndërhyrjen e drejtpërdrejtë. Ai është 100.000 Euro/USD, ose shumëfisha të kësaj shume;
- aa) **“Pezullim i kontaktimit”** – është përjashtimi i përkohshëm i një banke ose dege të bankës së huaj si partner tregtimi gjatë ndërhyrjes me veprim;
- bb) **“Komiteti”** – është Komiteti i Zbatimit dhe Këshillimit të Politikës Monetare në Bankë;
- cc) **“Trigger point”** – është niveli i kursit të këmbimit, arritja e të cilit do të përcaktojë momentin e fillimit të ndërhyrjes në rastin e ndërhyrjes sipas objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “c” të kësaj rregulloreje.

KREU II

Procesi i vendimmarrjes

Neni 4

Objektivat e ndërhyrjes në tregun e brendshëm valutor

Në përputhje me Ligjin e Bankës së Shqipërisë, objektivat e ndërhyrjes së Bankës në tregun e brendshëm valutor janë:

- a) rritja ose ulja e rezervës valutore;
- b) shmangia e çrregullimeve të tregut të brendshëm valutor;
- c) përmbushja e objektivave të politikës monetare ose të stabilitetit financiar, në të gjitha rastet kur ndërhyrja në tregun e brendshëm valutor për këto objektiva gjykohet e domosdoshme.

Neni 5
Ndërhyrja për ndryshimin e rezervës valutore

Komiteti vendos për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor për përmbushjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “a” të kësaj rregulloreje, bazuar në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare.

Neni 6
Ndërhyrja për shmangien e çrregullimeve në tregun e brendshëm valutor

Komiteti vendos për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor për përmbushjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “b” të kësaj rregulloreje, bazuar në propozimin e Departamentit të Operacioneve Monetare ose të Guvernatorit.

Neni 7
Ndërhyrja për objektiva të politikës monetare ose stabilitetit financiar

Këshilli Mbikëqyrës vendos për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor për përmbushjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “c” të kësaj rregulloreje, bazuar në propozimin e Departamentit të Politikës Monetare ose të Departamentit të Stabilitetit Financiar.

Neni 8
Vendimi për ndërhyrje

1. Vendimi i Komitetit për ndërhyrjen në tregun e brendshëm valutor përmban të paktën elementet e mëposhtme:
 - a) objektivin e ndërhyrjes;
 - b) llojin e ndërhyrjes;
 - c) instrumentin e ndërhyrjes;
 - d) kohëzgjatjen e ndërhyrjes, me përjashtim të ndërhyrjes sipas nenit 7.
2. Vendimi i Komitetit për ndërhyrjen në tregun e brendshëm valutor mund të përfshijë edhe elemente të tjera, të tilla si:
 - a) skedulin paraprak të ankandeve;
 - b) llojin e marrëveshjes, *spot* ose *forward*;
 - c) shumën maksimale të ndërhyrjes;
 - d) për ndërhyrjen sipas nenit 7, kohën gjatë të cilës ndërhyrja do të jetë efektive;
 - e) “*trigger points*”;
 - f) objektivin operacional;
 - g) sterilizimin ose jo të ndërhyrjes;
 - h) normën maksimale të pjesëmarrjes së një partneri në tregtim në çdo ankand, sipas nenit 13 të kësaj rregulloreje, pa përfshirë raundin e dytë.
3. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor, sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje, përmban një ose disa nga elementet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, dhe i delegon Komitetit elementet e tjera për t’u përfshirë në një vendim të tij. Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor mund të përmbajë edhe elemente të tjera, të ndryshme nga ato të

përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni. Në këtë rast, vendimi i Komitetit duhet të përmbajë elemente/instruksione që mundësojnë zbatimin e tij nga ana e Departamentit të Operacioneve Monetare.

4. Vendimi për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor, në llojin e ndërhyrjes me deklaratë, mund të merret nga Këshilli Mbikëqyrës, nga Komiteti ose nga Guvernatori. Vendimi për ndërhyrje me deklaratë mund të jetë në formë të shkruar ose jo dhe nuk është i detyrueshëm të përmbajë të gjitha elementet e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni.

KREU III

Zbatimi i vendimeve për ndërhyrje

Neni 9

Partnerët e tregimit

1. Banka i kryen ndërhyrjet në tregun e brendshëm valutor nëpërmjet bankave dhe degëve të bankave të huaja, të cilat kanë llogari në Bankë.
2. Në raste pamundësie të bankave dhe degëve të bankave të huaja për të përmbushur objektivin/at, Banka mund të kryejë ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor.
3. Partnerë të tregimit të Bankës, vetëm sipas nenit 14 të kësaj rregulloreje, mund të jenë edhe Qeveria, ASD dhe institucione financiare ndërkombëtare.

Neni 10

Llojet e ndërhyrjes sipas instrumentit dhe objektivit

1. Llojet e ndërhyrjes së Bankës në tregun e brendshëm valutor janë ndërhyrja me deklaratë dhe ndërhyrja me veprim. Ndërhyrja me veprim mund të jetë e drejtpërdrejtë ose me ankand.
2. Ndërhyrja me deklaratë përdoret për përmbushjen e secilit prej objektivave të përcaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje, si dhe për kombinime të tyre. Ajo realizohet nëpërmjet instrumenteve të ndërhyrjes si deklaratë në median e shkruar, median elektronike, konferencë për shtyp, dhe/ose çdo metodë tjetër komunikimi nëpërmjet së cilës mund të arrihen pjesëmarrësit e tregut dhe publiku i gjerë.
3. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë përdoret në rastin e ndërhyrjes për përmbushjen e objektivave të përcaktuar në shkronjat “b” dhe “c” të nenit 4 të kësaj rregulloreje. Instrument i realizimit të saj është kontaktimi i partnerëve të tregimit me synim lidhjen e marrëveshjes së menjëhershme *spot* ose *forward*.
4. Ndërhyrja me ankand përdoret në rastin e ndërhyrjes për përmbushjen e objektivit të përcaktuar në shkronjën “a” të nenit 4 të kësaj rregulloreje. Instrumenti i realizimit të saj është lajmërimi për organizimin e ankandit me bankat dhe degët e bankave të huaja për blerje ose shitje valute, nëpërmjet veprimeve financiare *spot* ose *forward*.

Neni 11

Monedhat e ndërhyrjes

1. Për realizimin e ndërhyrjes me veprim, Departamenti i Operacioneve Monetare përdor monedhën e përbashkët evropiane (EURO) ose dollarin amerikan (USD).
2. Departamenti i Operacioneve Monetare nuk i kuoton të dyja monedhat njëkohësisht.

Neni 12

Mënyra e realizimit të ndërhyrjes së drejtpërdrejtë

I. Njoftimi

Përveç se kur vendoset ndryshe, ndërhyrjet e drejtpërdrejta nuk njoftohen paraprakisht.

II. Zbatimi

Departamenti i Operacioneve Monetare është përgjegjës për zbatimin e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë, përfshirë kohën dhe numrin e ndërhyrjeve, në përputhje me elementet e vendimit për ndërhyrje të përcaktuara në nenin 8 të kësaj rregulloreje.

III. Përzgjedhja e partnerëve të tregtimit në ndërhyrjen e drejtpërdrejtë

1. Departamenti i Operacioneve Monetare përcakton numrin e bankave dhe degëve të bankave të huaja, të cilat do të jenë partnerët e tregtimit të Bankës për ndërhyrjet në tregun e brendshëm valutor nëpërmjet marrëveshjeve të drejtpërdrejta. Banka kontakton të paktën tre banka.
2. Kriteret për përzgjedhjen e bankave dhe degëve të bankave të huaja si partnerë tregtimi janë:
 - a) konkurrueshmëria e kurseve të këmbimit të shitjes ose blerjes në varësi të pozicionit të Bankës; dhe/ose
 - b) limitet e tregtimit të përcaktuara nga bankat dhe degët e bankave të huaja.
3. Në raste pamundësie të bankave dhe degëve të bankave të huaja për të përmbushur objektivin/at, Komiteti vendos të ndërhyhet nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor dhe Departamenti i Operacioneve Monetare është përgjegjës për hartimin e mënyrës së realizimit të ndërhyrjes.

IV. Pezullimi i partnerëve të tregtimit

1. , Në rastin kur bankat dhe degët e bankave të huaja nuk respektojnë limitin e komunikuar në lidhje me veprimet dypalëshe, apo në çdo rast të shkeljeve të detyrimeve dhe përgjegjësi të tyre në lidhje me veprimet financiare në valutë, Banka mund t'i pezullojë ato nga çdo ndërhyrje me veprim.
2. Departamenti i Operacioneve Monetare mund të vendosë për pezullimin e partnerit të tregtimit në përputhje me paragrafin IV, pika 1 të këtij neni, deri në takimin e ardhshëm të Komitetit. Ky i fundit mund të vendosë për zgjatjen e kohës së pezullimit dhe kushtet në të cilat ai mund të hiqet.
3. Pezullimi, në çdo rast, nuk do të kalojë 15 ditë pune, interval ky, gjatë të cilit Banka ndërhyr në tregun e brendshëm valutor nëpërmjet ndërhyrjeve të drejtpërdrejta.
4. Banka njofton bankat dhe degët e bankave të huaja nëpërmjet një shkrese zyrtare

mbi vendimin e marrë nga Departamenti i Operacioneve Monetare dhe/ose Komiteti në rast pezullimi.

V. Kursi i ndërhyrjes

Kursi i këmbimit për çdo ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor përcaktohet nga:

- a) kuotimet e bankave dhe degëve të bankave të huaja; ose
- b) kuotimi i Departamentit të Operacioneve Monetare; ose
- c) kombinimi i shkronjave të mësipërme, “a” dhe “b”.

VI. Shuma e ndërhyrjes

Shuma për çdo ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor përcaktohet nga:

- a) limitet e miratuara të bankave dhe degëve të bankave të huaja; dhe/ose
- b) gjykimi i Departamentit të Operacioneve Monetare në lidhje me veprime financiare në vlerë më të vogël se limiti i komunikuar nga banka ose më të lartë, në rastin kur partneri i tregtimit pranon një shumë më të lartë.

Neni 13

Mënyra e realizimit të ndërhyrjes me ankand

I. Njoftimi dhe publikimi

1. Data e zhvillimit të çdo ankandi njoftohet, si rregull, të paktën 1 muaj para datës së zhvillimit.
2. Menjëherë pas marrjes së vendimit nga Komiteti, Banka publikon në Reuters dhe në faqen e saj të internetit, kalendarin vjetor të ankandeve dhe bandën e shumave vjetore minimale dhe maksimale të blerjeve/shitjeve.
3. Publikimi i kalendarit vjetor të ankandeve, përcaktuar në paragrafin I, pika 2, të këtij neni, si rregull, bëhet para mbylljes së vitit kalendarik paraardhës dhe të paktën 1 muaj para zhvillimit të ankandit të parë.
4. Banka njofton bankat dhe degët e bankave të huaja nëpërmjet të paktën një prej mjeteve të komunikimit që vijnë: Reuters, Bloomberg, internet dhe çdo mjet tjetër që gjykon të arsyeshëm.
5. Banka njofton për orën e zhvillimit të ankandeve individuale, 2 ose 3 ditë pune përpara zhvillimit të tij. Në njoftim, Banka informon edhe normën maksimale të pjesëmarrjes, kur kjo është përcaktuar në vendimin e Komitetit.

II. Procedurat e ankandit

1. Përveç se kur vendoset ndryshe, ndërhyrja me ankand realizohet vetëm me bankat dhe degët e bankave të huaja.
2. Çdo pjesëmarrës në ankand mund të vendosë deri në 3 kuotime.
3. Çdo pjesëmarrës në ankand duhet të kuotojë një shumë minimale prej 100,000 Euro/USD për çdo kuotim ose shumëfisha të kësaj shume.
4. Departamenti i Operacioneve Monetare përcakton fituesit në ankand, bazuar në:
 - a) konkurrueshmërinë e kurseve të këmbimit të ofruara nga bankat dhe degët e bankave të huaja;
 - b) shumën që do të blihet/shitet në ankand.
5. Përcaktimi i fituesit/ve do të kryhet si më poshtë:

- a) Departamenti i Operacioneve Monetare, pasi të bëjë renditjen e kuotimeve prej kuotimit më të favorshëm financiarisht deri tek kuotimi më i pafavorshëm, do të përcaktojë si fituese të parë, kërkesën e parë në rradhë dhe do të vijojë me kuotimet pasuese në rend zbritës deri në përmbushjen e shumës minimale të ankandit;
 - b) Departamenti i Operacioneve Monetare do të ketë të drejtën për të vendosur mbi akordimin e kuotimeve pas përmbushjes së shumës minimale deri në shumën maksimale të ankandit;
 - c) Shuma maksimale nuk do të tejkalohet në asnjë rrethanë.
6. Në përfundim të çdo ankandi, Departamenti i Operacioneve Monetare, duke gjykuar në bazë të rezultateve të tij, kushteve të tregut, qëllimit të programit dhe informacioneve të tjera, ka të drejtën të vijojë zbatimin e ndërhyrjes në tregun e brendshëm valutor, nëpërmjet raundit të dytë si vijon:
- a) Departamenti i Operacioneve Monetare u ofron një, disa ose të gjithë partnerëve të tregtimit fitues, mundësinë për të tregtuar në çmimin mesatar të ponderuar të shumave të pranura në ankand. Çmimi mesatar i ponderuar rrumbullakoset në 2 shifra pas presjes;
 - b) Banka zgjedh të kontaktojë partnerët e tregtimit fitues brenda 60 minutave pas orës së zhvillimit të ankandit, duke filluar nga banka dhe dega e bankës së huaj me kursin më konkurrues në ankand;
 - c) Secilit prej partnerëve fitues të zgjedhur, i jepet e drejta të tregtojë një shumë shtesë të barabartë me shumën e akorduar si fituese në ankand. Partneri i zgjedhur ka të drejtë ta ushtrojë këtë të drejtë plotësisht ose pjesërisht.
7. Në raste pamundësie të bankave dhe degëve të bankave të huaja për të përmbushur objektivin/at, Komiteti vendos të ndërhyhet nëpërmjet zyrave të këmbimit valutor dhe Departamenti i Operacioneve Monetare është përgjegjës për hartimin e mënyrës së realizimit të ndërhyrjes.
8. Në rast të shkeljeve të procedurave të ankandit, aplikohet pezullimi sipas nenit 12, paragrafi IV të kësaj rregulloreje.

III. Shtimi dhe anulimi i ankandeve

1. Komiteti, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, mund të planifikojë ankande shtesë, të cilat nuk janë përfshirë në kalendarin vjetor fillestar të ankandeve, duke respektuar afatin minimal 1-mujor të lajmërimit sipas paragrafit I të pikës 1 të këtij neni.
2. Në rast planifikimi të ankandeve shtesë, Banka lajmëron bankat dhe degët e bankave të huaja me të paktën një nga mjetet e komunikimit: Reuters, Bloomberg, internet ose çdo mjet tjetër që e gjykon të arsyeshëm.
3. Komiteti, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, anulon në çdo moment një ose disa ankande para kryerjes së tij ose tyre, duke njoftuar për këtë partnerët e tregtimit dhe publikun, sikurse bëhet në rastin e njoftimit të ankandeve.
4. Anulimi i një ose disa ankandeve vendoset kur objektivat e ankandit janë arritur, kur ekzekutimi i ankandeve të planifikuara bie në kundërshtim me objektivat e ndjekur nga Banka ose kur gjykohet se organizimi i ankandit mund të nxisë çrregullime në tregun e brendshëm valutor.

Neni 14

Veprime të tjera financiare valutore

1. Përveç ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor të përcaktuara në këtë rregullore, Banka mund të ndërhyjë në tregun e brendshëm valutor edhe në rastet e miratimit të kërkesave të iniciuara nga Qeveria, ASD dhe institucione financiare ndërkombëtare.
2. Banka realizon veprimet financiare valutore sipas pikës 1 të këtij neni, vetëm pas miratimit të kërkesës (instruksioneve përkatëse në formë të shkruar ose mesazh *SWIFT*-i), dërguar nga përfaqësuesi i autorizuar i Qeverisë, i ASD-së dhe i institucioneve financiare ndërkombëtare.
3. Për veprime financiare valutore me vlera deri në 1 milion Euro ose kundërvlera e tyre, miratimi jepet nga Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare. Këto veprime financiare valutore janë të rralla, kryhen kur kanë natyrë operacionale, si dhe kur nuk çenojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuar në nenin 4 të kësaj rregulloreje.
4. Për veprime financiare valutore me vlera deri në 10 milionë Euro ose kundërvlera e tyre, por që nuk kalojnë shumën 20 milionë Euro kumulative brenda 1 muaji kalendarik, miratimi jepet nga Administratori i Bankës që ka në varësi Departamentin e Operacioneve Monetare. Këto veprime financiare valutore kryhen kur nuk çenojnë përmbushjen e objektivave të përcaktuar në nenin 4, shkronjat “b” dhe “c” dhe ndikimi në objektivin e përcaktuar në nenin 4, shkronja “a” të kësaj rregulloreje është minimal. Pavarësisht përcaktimeve të mësipërme për shumat dhe objektivat, në rast se këto veprime janë të shpeshta, Administratori mund të refuzojë kërkesën, dhe në këtë rast, Departamenti i Operacioneve Monetare e dërgon atë për miratim në Komitet.
5. Për veprime financiare valutore për vlera më të mëdha se ato të përcaktuara në pikën 4 të këtij neni, miratimi jepet nga Komiteti. Këto veprime financiare valutore kryhen për përmbushjen e objektivit të përcaktuar në nenin 4, shkronja “b” të kësaj rregulloreje.
6. Kursi i këmbimit me qëllim kryerjen e veprimeve të tjera financiare *spot* luhatet deri në ± 2.00 për qind të kursit të tregut, në momentin e lidhjes së marrëveshjes. Kursi i këmbimit për veprimet financiare *forward* ose veprimet financiare *forward* që janë pjesë e një marrëveshjeje *swap*, përcaktohet nga kursi *spot* dhe diferenca e normave të interesit të tregut për afatin e marrëveshjes, të monedhave të përfshira në veprimin financiar, në përputhje me standardet ndërkombëtare të tregtimit.

Neni 15

Komunikimi pas ndërhyrjes

1. Banka publikon në faqen e saj të internetit shumën e të gjitha ndërhyrjeve në tregun e brendshëm valutor në javën e fundit të tremujorit, që pason tremujorin gjatë të cilit janë kryer ndërhyrjet.
2. Banka, në rastin e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta me një kurs të vetëm, njofton partnerët e tregtimit me të cilët ka kontakte për ndërhyrjen dhe kursin e këmbimit të ndërhyrjes.

3. Banka, në rastin e ndërhyrjeve të drejtpërdrejta, të kryera me kurse këmbimi të ndryshme, njofton partnerët e tregtimit me të cilët ka kontakte, vetëm për faktin që ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor dhe jo për kurset e këmbimeve të ndërhyrjes.
4. Banka, në rastin e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë, në çdo moment mund të informojë publikun e gjerë rreth ndërhyrjes, objektivit të saj dhe shumës së tregtuar.
5. Banka, në rastin e ndërhyrjeve me ankand, publikon shumën e ofruar në ankand, shumën e pranuar në ankand, bandën e kurseve të ofruara, bandën e kurseve të pranuara, proratën në kursin maksimal të pranuar, kursin mesatar të ponderuar, si edhe elemente të tjera që mund t'i gjykojë të nevojshme në varësi të rastit.
6. Banka, në rast të lidhjes së marrëveshjeve në raundin e dytë pas përfundimit të ankandit, publikon menjëherë shumën e tregtuar dhe kursin e tregtimit.

Neni 16

Konfidencialiteti

1. Të gjitha dokumentet dhe informacionet që kanë lidhje me marrjen e vendimit për ndërhyrje në tregun e brendshëm valutor trajtohen si informacion jopublik profesional në përputhje me rregulloren e Këshillit Mbikëqyrës “Për transparencën dhe konfidencialitetin në Bankën e Shqipërisë”, e ndryshuar, dhe udhëzimin e Guvernatorit “Mbi rregullat për përdorimin dhe klasifikimin e informacionit “sekret bankar” në Bankën e Shqipërisë”.
2. Përveç sa parashikohet në nenin 15 të kësaj rregulloreje, organet vendimmarrëse të ndërhyrjes në tregun e brendshëm valutor mund të vendosin të bëjnë të njohur publikisht një pjesë ose të gjithë vendimin.

Neni 17

Të fundit

1. Me zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen Komiteti, Departamenti i Operacioneve Monetare, Departamenti i Politikës Monetare, Departamenti i Stabilitetit Financiar në Bankë dhe Kabineti i Guvernatorit.
2. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 2, datë 16.1.2012 “Për miratimin e rregullores “Mbi procedurat e ndërhyrjes së Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore””, i ndryshuar.

KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS

Gent SEJKO